



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 14.9.2020

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 14.9.2020, para trupit gjykues, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 112, datë 4.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Dritan Peka.

Të nderuar zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

Referuar shkaqeve të ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik për vendimin nr. 112, datë 4.3.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Peka dhe vendimit të ndërmjetëm të Kolegjit për lejimin e marrjes në cilësinë e provave të tri akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit: (i) shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2020, e Entit Kombëtar të Banesave; (ii) shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2019, e Prokurorisë së Përgjithshme dhe (iii) analizë financiare, të sjellë nga subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik, referuar shpjegimeve dhe provave të pretenduara, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 22.7.2020, vlerëson se, nga ana formale, aktet e paraqitura nga subjekti përmbushin kërkesat formale për t'u administruar në cilësinë e provës.

Lidhur me parashtrimet dhe aktet e paraqitura nga subjekti, për sa i përket përmbajtjes së tyre vlerësojmë se:

**1.** Në lidhje me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2020, të Entit Kombëtar të Banesave, me lëndë kthim përgjigje znj.\*\*\*.\*\*\*. (bashkëshortja e subjektit), në përgjigje të kërkesës së kësaj të fundit, ku citohet se: *“...në vijim të verifikimit të kryer nga ana jonë rezulton se dosja juaj është e plotë me dokumentet konform kërkesave të VKM-s nr.600/2007 (aktualisht e shfuqizuar, por që ka qenë në fuqi në periudhën e miratimit të kredisë së lehtësuar me 4% interes)”*. Shkresa është vërtetim i njësish me origjinalin me nr.\*\*\* repertori, datë \*\*\*.7.2020, e noterës \*\*\*.\*\*\*;

1.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, duke pasur parasysh se nënçështjet për këtë shkak ankimi janë: (1) aplikimi, (2) përfitimi dhe (3) përdorimi i kësaj kredie me kushte lehtësuese, ky akt i paraqitur dëshmon se dokumentacioni është i plotë konform kërkesave të VKM-së nr. 600/2007. Gjithashtu, Komisioneri Publik sqaron se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka përfituar në mënyrë ligjore kredinë me kushte lehtësuese, pasi pozicioni i juristes që ajo mbante në kohën e aplikimit të kredisë ekuivalentohet me pozicionin Drejtor Drejtorie, me kategori page II-b.

**2.** Në lidhje me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2019, të Drejtorit të Drejtorisë së Studimeve, Inspektimit dhe Çështjeve të tjera Ligjore, në Prokurorinë e Përgjithshme, drejtuar

subjektit z. Peka, me anë të së cilës bëhet njoftimi i një kopjeje të vendimit nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm, për arkivimin e ankesës. Shkresa është vërtetim i njësisë me origjinalin me nr.\*\*\* repertori, datë \*\*\*.7.2020, e noteres \*\*\*.\*\*\*. Për sa më sipër rezulton se:

a. Komisioni, në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr.112, datë 4.3.2019, ka vendosur “*në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, praktikën që lidhet me përzgjedhjen dhe punësimin e z.\*\*\*.\*\*\*, pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, si dhe në lidhje me kohëzgjatjen e lejes, prezencën apo jo të tij në vendin e punës dhe me pagesat e përfituara prej tij nga ky institucion, përgjatë periudhës korrik - tetor 2015*”;

b. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2019, bazuar në nenin 160, pika 5, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka përcjellë pranë Prokurorit të Përgjithshëm, si organi kompetent për hetimin e shkeljeve disiplinore të prokurorëve deri në krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, zhvillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurorit Dritan Peka – Drejtues i Prokurorisë së Apelit Tiranë;

c. Prokurori i Përgjithshëm, me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2019, ka vendosur: “*Të arkivojë kërkesë/ankesën nr. prot.\*\*\*, datë \*\*\*.10.2019, për hetim disiplinor në lidhje me subjektin e rivlerësimit Dritan Peka – Drejtues i Prokurorisë së Apelit Tiranë, të përcjellë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në Prokurorinë e Përgjithshme*”.

2.1 Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, arsyet e kësaj vendimmarrje janë bazuar në afatet e parashkrimit për hetimin disiplinor të shkeljeve sipas nenit 28, pika 2, të ligjit nr. 8738, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si ligji i kohës dhe favorizues për kohën /çastin kur është kryer shkelja, dhe nenit 172 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, vendimi nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2019, i Prokurorit të Përgjithshëm, nuk jep përgjigje lidhur me çështjet për të cilat Komisioni ka bërë transferimin pranë organit kompetent inspektues, si dhe nuk provon nëse Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi kushtetues që ka në përgjegjësi marrjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve, ka disponuar më tej lidhur me këtë vendim.

3. Në lidhje me aktin: “Analizë e pasurisë dhe e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Peka, 2003 – 2016”, të nënshkruar nga studio “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., nga vlerësimi i zërave të pasqyrës së analizës financiare, të detajuar për çdo vit, për periudhën 2003 – 2016, e cila është pjesë e aktit të paraqitur, konstatojmë si vijon:

- Në zërin e të ardhurave nga pagat<sup>1</sup>, evidentohen mospërputhje në shpërndarjen e të ardhurave sipas viteve, kryesisht për të ardhurat e bashkëshortes nga mësimdhënia, të cilat pavarësisht nga shpërndarja ndër vite, nuk ndikojnë në diferencën totale të konstatuar.

---

<sup>1</sup> Të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes, të përfshira në analizë nga Komisioneri Publik, janë bazuar në aktet e administruara nga KPK-ja: - Vërtetim nga Prokuroria e Përgjithshme, për periudhën dhjetor 2016, shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2017 dhe periudhën 2009 – 2016, dhe shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016; - Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës, për vitin 2015, shkresa me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016; - Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, periudha 2008 – 2016, shkresa nr. extra prot., datë \*\*\*.1.2017; - Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, periudha 1998 – 2008, datë \*\*\*.10.2016; - Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, periudha 2000 – 2003, shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016; - Vërtetim nga Instituti i Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës, viti 2012, shkresa nr.\*\*\* prot., datë

- Në zërin e shpenzimeve në analizë, konstatojmë se nuk janë përfshirë shpenzimet e jetesës sipas INSTAT-it, për familjen e subjektit, në përbërje të së cilës janë tre anëtarë.
- Në zërin e “Shpenzimeve për udhëtime jashtë shtetit”, ka mospërputhje për udhëtime jashtë shtetit, si për periudhën e udhëtimeve, ashtu edhe me përlogaritjen e tyre<sup>2</sup>. Në analizë janë vendosur shpenzimet e udhëtimit, të njëjta me ato që ka deklaruar subjekti, gjatë procedurës hetimore. Gjithashtu konstatojmë se në analizë nuk janë përfshirë shpenzimet e udhëtimit për jashtë shtetit të kryera nga subjekti dhe personat e lidhur në vitin 2008 dhe vitin 2010, të identifikuar nga sistemi TIMS.
- Në fund të çdo viti analizues evidentohet zëri “Kursime në fund të vitit”, të cilat janë të paspecifikuara, nëse janë likuiditete të disponuara në *cash* apo likuiditete në sistemin bankar. Konstatojmë se zëri “Kursime në fund të vitit”, i paraqitur në analizë, nuk përputhet me kursimet e deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore.
- Zëri “Kursime në fund të vitit”, në analizën e paraqitur nga subjekti, nuk përputhet me deklaratimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit të hetimit, me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.8.2018, “...Lutemi deklaroni sa ka qenë gjendja e likuiditeteve *cash* dhe në bankë në fund të çdo viti, respektivisht për periudhën 2003 – 2016”.
- Në analizë nuk identifikohet përdorimi e likuiditeteve *cash* të akumuluar dhe të përdorura nga subjekti, gjatë transaksioneve për blerjen e pasurive të paluajtshme, të luajtshme dhe ndryshimeve në llogaritë bankare.

3.1 Lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar, të paraqitur në prapësimet e datës 22.7.2020, subjekti thekson se: “... në deklarin periodik vjetor, kam deklaruar kursimet dhe shpenzimet që janë bërë për atë vit...<sup>3</sup>”. Në këtë kuadër, Komisioneri Publik mban të njëjtin qëndrim, që analiza e likuiditeteve *cash*, jashtë sistemit bankar, bazohet në deklaratat periodike vjetore të subjektit të dorëzuara në ILDKPKI. Ky qëndrim bazohet në vendimet e Kolegjit (JR) nr. 11/2019, në prg. 27; (JR) nr. 19/2019, në prg. 84; (JR) nr. 20/2019, në prg. 59; (JR) 7/2019, prg. 39.

## KOMISIONERI PUBLIK

### Darjel SINA

---

\*\*\*.10.2016; - Vërtetim nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, vitet 2006, 2010, 2016, shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016; -Vërtetim nga \*\*\* University, vitet 2008 – 2010 dhe 2012 – 2016, shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016; - Vërtetim nga shkolla private e arsimit të lartë “\*\*\*”, Vlorë, periudha 2013 – 2014, datë \*\*\*.10.2016; - Vërtetim nga Kryeministria, paga neto për periudhën 1997 – 2016; shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016 dhe nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2017; - Shkresë Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, periudha 2011 – 2012 dhe 2015 – 2016 shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2017; Vërtetim nga Ministria e Financave, periudha 2008 – 2010 dhe 2012 – 2013, nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2016; -Vërtetim nga Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike, periudha 2010 – 2016, shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016; - Vërtetim nga Ministria e Mbrojtjes, periudha qershor – nëntor 2003, shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016.

<sup>2</sup> Nga Komisioneri Publik, shpenzimet e përfshira për udhëtime jashtë shtetit janë identifikuar me të dhënat e sistemit TIMS, duke përfshirë udhëtimet e kryera dhe të dokumentuara për qëllime pune. Janë përfshirë shpenzimet për udhëtime të identifikuar dhe të realizuara nëpërmjet sistemit bankar, në rastin kur subjekti ka pretenduar dhe dokumentuar se është akomoduar pranë të afërmeve, shpenzimet e akomodimit nuk janë marrë në konsideratë, shpenzimet për biletat e udhëtimit janë bazuar në çmimet e publikuara në faqen e internetit të kompanive ajrore dhe destinacionit përkatës. Ndërsa për udhëtimet e padokumentuara, shpenzimet e padokumentuara janë përfshirë në analizë.

<sup>3</sup> Referuar paragrafit të pestë, faqe 14, të prapësimeve të subjektit, të paraqitura në Kolegj në seancën e datës 22.7.2020.